



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 728/2 Prot.

Tiranë, më 29/5/2017

REKOMANDIM

Nr. 14 datë 29/5/2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Universiteti "*Marin Barleti*" sh.a. Tiranë me NIPT:K52115006H,

VËREJ SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr.123 datë 26.04.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Universiteti "*Marin Barleti*" sh.a. Tiranë me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Universiteti "*Marin Barleti*" sh.a. Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrit Nr.123, datë 26.04.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi "*Marin Barleti*" sh.a., zhvillon programe të akredituara të studimeve në fakultetet e shkencave të aplikuara e ekonomike, drejtësi e shkencë sociale e politike etj.

Kontrolluesi përpunon të dhëna personale kryesisht për subjektet e dhënave "*punëmarrës*" dhe "*studentë*". Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale (nëpërmjet dokumentacionit në formatin letër) si dhe në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit të tilla si sistemi i video-vëzhgimit (CCTV), portali zyrtar i institucionit, pajisje kompjuterike etj.

Gjatë hetimit administrativ të ushtruar në vend, është konstatuar:

1. Kontrolluesi ka kryer detyrimin për "*Njoftim*" pranë Zyrës së Komisionerit, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale por nuk ka kryer përditësimin e këtij njoftimi për sa i përket ndryshimeve që ka pësuar aktiviteti nga periudha fillestare e këtij "*Njoftimi*".

Ndryshimet konsistojnë në deklarimin e përpunimit të të dhënave nëpërmjet sistemit të video vëzhgimit (CCTV), hartimi i rregullores etj.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 21 dhe 22 të ligjit - *"1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë."*

2. Kontrolluesi disponon rregullore për *"Përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale"*, por duhet të formalizohet dhe përshtatet në funksion të aktivitetit të kontrolluesit.
3. Kontrolluesi mbikëqyr ambientet e brendshme dhe të jashtme nëpërmjet sistemit të video vëzhgimit (CCTV), por nuk disponon rregullore në lidhje me funksionimin e këtij sistemi. Koha e ruajtjes së të dhënave imazhe-video konstatohet 14 ditë. Grupi i kontrollit konstatoi se kontrolluesi informonte subjektet e të dhënave mbi prezencën e sistemit të video vëzhgimit (CCTV) nëpërmjet tabelave informuese, por jo sipas modelit standard të miratuar nëpërmjet Udhëzimit Nr.46 të Komisionerit për, *"Përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të Ligjit Nr.19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë"*.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit dhe Udhëzimit Nr.46 të Komisionerit, e konkretisht nenit 6, pika 1, germa "e" e tij - *"1) Çdo subjekt publik dhe privat i cili vendos masat shtesë të sigurisë, ka për detyrë:*

e) të mbajë dhe administrojë të dokumentuar veprimet e kryera gjatë përpunimit të të dhënave personale me mjetet shtesë të sigurisë".

4. Kontrolluesi nuk ka publikuar në portalin zyrtar <http://www.umb.edu.al> *"Politikat e Privatësisë"*. Informacioni i publikuar në *"Politikat e Privatësisë"*, ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit - *"1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit..."*.

Në përfundim të procedurës së kontrollit, Zyra e Komisionerit, mban në konsideratë faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e hetimit administrativ gjatë ushtrimit të kontrollit.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi Universiteti "*Marin Barleti*" sh.a. Tiranë, të realizojë në vazhdimësi përditësimin e Formularit të Njohimit.
2. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi Universiteti "*Marin Barleti*" sh.a. Tiranë, të formalizojë dhe përshtatë në funksion të aktivitetit të tij rregulloren për "*Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhëve Personale*".
3. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe Udhëzimit Nr.46 datë 28.03.2017 të Komisionerit, kontrolluesi të hartojë rregullore për funksionimin e sistemit të vëzhgimit (CCTV), si dhe të standartizojë tabelën e informimit në përputhje me këtë udhëzim.
4. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Universiteti "*Marin Barleti*" sh.a. Tiranë, të hartojë dhe publikojë në portalin zyrtar të tij, rubrikën "*Politikat e Privatësisë*".
5. Kontrolluesi Universiteti "*Marin Barleti*" sh.a. Tiranë, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda afatit 20 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
6. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 29/5/2017

BESNIK DERVISHI

KOMISIONERI